

AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "GERTI" SH.P.K.

Personi që firmos më poshtë :

Shaip Përlica i biri i Nuredinit dhe i Shahijes , lindur ne Grazhdan , DIBER , banues ne Bulqizë , identifikuar me Çertifikatën e Lindjes Nr. 30/25 leshuar nga Z.GJ.Civile Bulqizë

ka hartuar si më poshtë vijon Aktin e Themelimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të cilën ka vendosur ta themelojë :

Në mbështetje të ligjit nr. 7638 , datë 19. 11.1992 "Për shoqëritë tregtare", unë ortaku i vetëm Shaip Përlica , vendosa krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "GERTI" SH.P.K.

për të zhvilluar aktivitet privat me objekt të veprimtarisë së saj:

Aktivitet ndertimor ne perputhje me Liçensën Z.0553 te Drejtuesit Teknik z.Refik HOXHA , leshuar me 10.10 .1995 dhe e vlefshme deri me 25.09.2000, per kategorie e punimeve si me poshte :

- kat 1 Punime dheu, sistemime , tarracime terrenesh
- kat 3 /a ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to
- /b ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to
- kat 4 /a ndertim rruge kat.V, VI
- kat 8 /b ndertim ujsjellsash e kanalizime
- kat 9 /a sillosa , kulla , kulla uji, etj prej b/armeje
- /b sillosa , kulla , kulla uji, etj metalike
- kat10 /a rikonstruksion godinash civile e ekonomike, veshje fasadash,etj
- kat14 /d mirembajtje e zhvillim i dekorit ne mjedise urbane.

* Import - eksport si dhe tregtim me shumicë e pakicë te blloqeve te betonit brenda vendit dhe materialeve te ndertimit , si dhe prodhim dhe transportim te tyre; duhan, cigare mallra ushqimorë, bujqesor e blektoral, bime mjeksore ; konfeksione e tekstile , këpucë të çdo lloji, galanteri dhe artikuj lekure ; karburanteve, nënprodukteve të naftës, vajrave për mjetet e transportit dhe nevojat e industrisë, lubrifikante, lende djegese, vajguri , gaz te lenget; të lëndëve të para për prodhimin e mobilieve, makinerive për prodhimin dhe përpunimin e lëndës drusore si dhe pjesë këmbimi për to; kablllo elektrik dhe telefonik të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme, pllaka, paisje hidrosanitare e termosanitare e termoizolues si dhe cdo artikulli tjetër për ndertim e mirmbajtje shtepish, paisjeve elektroshtëpiake, elektrike, elektroteknike dhe elektronike si dhe pjesë këmbimi për to; makineri e paisje për industrine minerare dhe perpunuese

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqind mijë) lekë,
Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe mbi 10 (dhjetë) vjetë



Selia do të jetë në , Bulqize , Lagjia e Re
Administratori i shoqërisë do të jetë z. Shaip Përlica
Drejtues Teknik i shoqërisë do të jetë z. Refik HOXHA
Përfaqësimi ndaj të tretëve do të bëhet nga administratori i shoqërisë
Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit .

Viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 dhjetor 1999 . Çdo vit tjetër financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Çdo gjë që do të kryhet parashikohet në statutin që do të depozitohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë .

Ky Akt - Themelimi është hartuar ,më 16.7. 1999. në katër kopje origjinale duke patur fuqi të barabartë ligjore.

Ortaku i vetëm
i "GERTI" SH.P.K.

Shaip Përlica

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË
T I R A N Ë
Nr...62.7.....Rep
Nr.....7.9.....Kol

V È R T E T I M

Sot më datë 16.7......1999, në Zyrën e Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht para meje ortaku i vetëm i

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
i "GERTI" SH.P.K.


Shaip Përlica

me identitetin e mësipërm, i cili më deklaroi se *Akti i Themelimit* i mësipërm është sipas vullnetit të tij të lirë e të plotë dhe unë noterja duke e gjetur konform ligjit e vërtetoj atë .

NOTERE

PULLE TAKSE

Ulogj'indato
(Signature)



STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"GERTI" SH.P.K.

Personi që firmos më poshtë :

Shaip Përlica i biri i Nuredinit dhe i Shahijes , lindur ne Grazhdan , DIBER , banues ne Bulqizë , identifikuar me Çertifikatën e Lindjes Nr. 30/25 leshuar nga Z.GJ.Civile Bulqizë

ka hartuar si më poshtë vijon Statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të cilën ai ka vendosur ta themelojë :

1.

HYRJE

- 1.1 Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "GERTI" SH.P.K. krijohet mbi bazën e iniciativës së lirë dhe kapitalit themeltar të ortakut të vetëm Shaip Përlica
- 1.2 Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "GERTI" SH.P.K. krijohet dhe e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me të gjithë nenet e këtij statuti dhe të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë .
- 1.3 Kjo shoqëri si Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar i përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së kapitalit themeltar.

2.

OBJEKTI

Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë së saj :

Aktivitet ndertimor ne perputhje me Liçensën Z.0553 te Drejtuesit Teknik z.Refik HOXHA , leshuar me 10.10 .1995 dhe e vlefshme deri me 25.09.2000, per kategoria e punimeve si me poshte :

- | | | |
|-------|----|--|
| kat 1 | | Punime dheu, sistemime , tarracime terrenesh |
| kat 3 | /a | ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to |
| | /b | ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to |
| kat 4 | /a | ndertim rruge kat. V, VI |
| kat 8 | /b | ndertim ujsjellsash e kanalizime |
| kat 9 | /a | sillosa , kulla , kulla uji, etj prej b/armeje |
| | /b | sillosa , kulla , kulla uji, etj metalike |
| kat10 | /a | rikonstruksion godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj |
| kat14 | /d | mirembajtje e zhvillim i dekorit ne mjedise urbane. |

* Import - eksport si dhe tregtim me shumicë e pakicë te blloqeve te betonit brenda vendit dhe materialeve te ndertimit , si dhe prodhim dhe transportim te tyre; duhan, cigare maltra



ushqimorë, bujqesor e blektoral, bime mjeksore ; konfeksione e tekstile , këpucë të çdo lloji, galanteri dhe artikuj lekure ; karburanteve, nënprodukteve të naftës, vajrave për mjetet e transportit dhe nevojat e industrisë, lubrifikante, lende djegese, vajguri , gaz te lenget; të lëndëve të para për prodhimin e mobilieve, makinerive për prodhimin dhe përpunimin e lëndës drusore si dhe pjesë këmbimi për to; kablllo elektrik dhe telefonik të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme, pllaka, paisje hidrosanitare e termosanitare e termoizolues si dhe çdo artikulli tjetër për ndërtim e mirmbajtje shtëpish, paisjeve elektroshtëpiake, elektrike, elektroteknike dhe elektronike si dhe pjesë këmbimi për to; makineri e paisje për industrinë minerare dhe përpunuese

3.

EMRI , SELIA , TERRITORI

- 3.1 Kjo shoqëri do të quhet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "GERTI" SH.P.K. Shoqëria do të krijojë personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë,
- 3.2 Shoqëria do të ketë selin e saj në Bulqizë, Lagjia e Re ,
- 3.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

4.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

- 4.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakut të vetëm Shaip Përlica , me vlefë 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 4.3 Kapitali themeltar i shoqërisë mund të shtohet në varësi të rezultateve dhe nevojave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.

FONDET E SHOQËRISË

- 5.1 Shoqëria përcakton fondet e mëposhtme : Fondin themelor (qarkullues)
Fondin rezervë
Fonde të tjera të cilat mund të jenë të nevojshme gjatë veprimtarisë së saj .
- 5.2 Masa e secilit fond dhe mënyra e përdorimit të secilit prej fondeve përcaktohet me vendim të ortakut të vetëm .

6.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 6.1 Shoqëria do të drejtohet nga administratori z. Shaip Përlica
- 6.2 Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore do të hartohen nga administratori .
- 6.3 Administratori mund të delegojë kompetencat e tij.



6.4

Administratori miraton llogaritë, nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar prej tij, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar .

7.

KOMPETENCAT E ORTAKUT TË VETËM

- 7.1 Vendos për ndryshimet në Statut dhe miraton rregulloren e shoqërisë.
- 7.2 Vendos për politikën afariste të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së shoqërisë .
- 7.3 Shqyrton bilancin vjetor, fondet e ndryshme si dhe fitimin e realizuar .
- 7.4 Vendos për krijimin e degëve e agjensive të shoqërisë brenda dhe jashtë vendit .
- 7.5 Vendos për marrjen e kredive si dhe për mbarimin e shoqërisë .
- 7.6 Vendos për shëndrrimin e shoqërisë nga sh.p.k. në shoqëri të llojeve të tjera
- 7.7 Miraton ose realizon marrdhëniet e shoqërisë me persona të tjerë fizikë dhe juridikë
- 7.8 Vendos për pagat e punonjësve të punësuar në këtë shoqëri .
- 7.9 Emëron një ose disa ekspertë kontabël për të ushtruar kontroll mbi aktivitetin ekonomik - financiar të shoqërisë .

8.

NDARJA E FITIMIT

- 8.1 Pas përballimit të detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve të ndryshme, ortakut të vetëm i mbetet në dispozicion fitimi neto .
- 8.2 Fitimi neto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit, për shtimin e kapitalit themeltar dhe për kapital në natyrë .

9.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

- 9.1 Kjo shoqëri krijohet për një afat të pakufizuar e mbi 10 (dhjetë) vjetë.

10.

MBARIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Veprimtaria e shoqërisë mbaron ose mund të shpërbëhet në cdo kohë sipas vendimeve që do të marrë ortakut i tij i vetëm në rast se veprimtaria e tij nuk rezulton fitimprurëse, për shkak të forcave madhore si dhe për shkaqe të tjera ligjore .
- 10.2 Shoqëria mund të mbarojë me anë të thithjes së saj apo bashkimit.



11.

MARRDHËNIET E PUNËSIMIT

- 11.1 Çdo person i punësuar në shoqëri konsiderohet si i punësuar mbi bazën e kontratës së punës të lidhur ndërmjet tij dhe shoqërisë në përputhje me legjislacionin e punës në Shqipëri .
- 11.2 Çdo person i punësuar në shoqëri është personalisht përgjegjës për kryerjen e detyrës .
- 11.3 Shoqëria merr përsipër t'i sigurojë çdo të punësuarit respektimin e ligjeve e rregullave të punësimit e të sigurimeve shoqërorë .
- 11.4 Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit nëse në kontratën e punës nuk parashikohet ndryshe .
- 11.5 Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës në shoqëri . Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga kjo shoqëri

12.

DISPOZITA TË FUNDIT

- 12.1 Viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 dhjetor 1998 . Çdo vit tjetër financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 12.2 Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet në Insitutin e Sigurimeve të Republikës së Shqipërisë (INSIG).
- 12.3 Shoqëria do të ketë vulën e saj.
- 12.4 Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit ,do të zgjidhen me mirëkuptim dhe kur mirëkuptimi nuk arrihet organi kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit .
- 12.5 Ky Statut është hartuar më, 16. E. 1999, në katër kopje origjinale duke patur fuqi të barabarte ligjore.

Ortaku i vetëm
i "GERTI" SH.P.K.
Shaip Përliça